

# Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën



## Programi i bursave World University Service

Nëntor 2016

Programi i bursave World University Service financohet nga Ministria e Ekonomisë, Energjetikës, Transportit dhe Zhvillimit Rajonal të Hessen në Gjermani. Ai organizohet dhe ndiqet nga Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri me pëfaqësuese Znj. Eda Terezi.



Qëllimi i tyre është të forcojnë elitën arsimore në Shqipëri dhe të sigurojnë një gjeneratë të re të specialistëve të trajnuar mirë dhe t'i japin të rinjve shqiptarë një mundësi për të zhvilluar perspektiva profesionale në vendin e tyre.



Viti 2016 ishte viti i fillimit të implementimit të këtij programi në Shqipëri, i cili rezultoj mjaft i sukseshëm. Pjesë e këtij programi bursash u bënë dhe 6 studentë në vitin e tretë të degëve Menaxhim i Bankave dhe Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në FASTIP. Këta, të perzgjedhur nga 50 studentë në rang kombëtar përmbushnin kushtet për përfitimin e kësaj burse si: rezultate të larta akademike, aftësi të shkëlqyera komunikuese në disa gjuhë të huaja, aftësi këto të përmirësuar falë mësimdhënies nga pedagogë të huaj të ftuar në FASTIP. Studentët e perzgjedhur nga FASTIP-i ishin:

- Ervina Dermyshe
- Ledian Zerba
- Selda Tafciu
- Sidorela Delilaj
- Serina Dyrmishi
- Romina Elezi



# Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën



## Programi i bursave World University Service

Pjesëmarrja konsistonte në përfitimin e një granti prej 250\$ në muaj për periudhën Nëntor 2016-Prill 2017, gjetjes së një vendi praktike ku do të vihej në praktikë çdo informacion akademik i marrë dhe studimi i tregut të punës.

Gjatë kohëzgjatjes së këtij programi ata githashtu u bënë pjesë të disa trajnimeve dhe konferencave.

Fillimisht u mbledhën për kurset e trajnimit në Durrës (19-20 nëntor 2016) dhe Shkodër (09-11 dhjetor 2016).

Në fillim të këtyre trajnimeve dy-ditore, pjesëmarrësve u treguan se si të vlerësojnë veten në mënyrë që të njohin pikat e forta, si dhe fushat në të cilat ato ende mund të përmirësohen. Trajnimi vazhdoi me informimin rreth procesit të përgjithshëm të aplikimit dhe kërkesave të tregut të punës. Për më tepër, studenteve u mësuan aftësi

dhe kompetenca specifike të nevojshme për përgatitjen e praktikave dhe të profesionit të ardhshëm.

Seminaret u pritën mirë nga të gjithë bursistët dhe instruktorët. Të dyja palët ishin të kënaqur me rezultatin e përgjithshëm të seminareve dhe dhanë përshtypje pozitive, si dhe sugjerime për përmirësime të mëtejshme.



Finalizimi i kësaj eksperience ishte ndarja e certifikatave nga Minister-President i Landit të Hessen Volker Boufier, Ambasadorja Gjermane në Shqipëri, Znj.Susanne Schutz dhe disa nga deputetët e qeverisë gjermane në një takim të mbajtur në Ambasadën Gjermane në Tiranë.

World University Service bazuar në eksperiencën shumë të sukseshme ka rihapur dhe një herë aplikimet për të gjithë studentët e universiteteve publike që janë në përfundim të ciklit Bachelor apo Master. Në aplikimet që mbyllen me 25 qershor studentët e FASTIP kanë treguar edhe një herë interes të madh duke u bërë pjesë, duke përfaqësuar denjësisht fakultetin të cilit i përkasin.

